



RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

Bordi i Drejtorëve

RAPORTI VJETOR 2002

Prishtinë, 2003

BORDI I DREJTORËVE I RTK

ADEM DEMAÇI / KRYETAR
VJOSA DOBRUNA / NËN KRYETARE
BLERIM REKA / NËN KRYETAR
MILAZIM KRASNIQI / ANËTAR
NUHI REXHEPI / ANËTAR
Ati NEKTARIJE / ANËTAR
BORIS BERGANT / ANËTAR
YASHA LANGE / ANËTAR
SOPHIE SAKALIS / ANËTARE

MENAXHMENTI

AGIM ZATRIQI / DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ASTRIT SALIHU / ZV DREJTOR I PËRGJITHSHËM
AVNI SPAHIU / DREJTOR I TELEVISIONIT
SYLEJMAN SHAQIRI / DREJTOR I RADIO KOSOVËS DHE RADIOS BLUE
SKY
BUJAR SPAHIU / DREJTOR FINANCIAR
AGRON DIDA / DREJTOR I OPERACIONEVE DHE TEKNIKËS
ELVANA PREKAZI / DREJTORESHË PËR ÇËSHTJE JURIDIKE DHE
ADMINISTRATIVE
BUKURIJE GJONBALAJ / MENAXHERE PËR ZHVILLIM
GAZMEND BADIVUKU / SHEF I SIGURIMIT

PARATHËNIE NGA KRYETARI I BORDIT TË DREJTORËVE TË RTK-së

Ja ku po paraqitemi edhe një herë me një pasqyrë të veprimtarisë sonë gjatë vitit 2002.

Ky vit ishte një vit i zgjerimit dhe të kompletimit të veprimtarisë sonë programore, por edhe kompletimi i kuadrit juridik dhe rregullativ sa i takon punëve tona të përditshme dhe të punëve dhe planifikimeve me afat të gjatë.

Përkundër vështirësive të shumta RTK-ja arriti që, me cilësinë e programeve të veta të mbetet programi më i shikuar dhe me besueshmëri më të madhe në Kosovë dhe jashtë Kosove. Mirëpo, ne si Bord, bashkë me menaxhmentin, duke pasur parasysh mundësitë tona krijuese ende nuk jemi as përsëafërmi të kënaqur me shkallën e cilësisë së arritur të programeve tona. Jemi duke u përgatitur dhe duke marrë masa energjike që të arrijmë lartësi edhe më serioze kreative. Me këtë qëllim, Bordi ka sugjeruar dhe ka kërkuar nga menaxhmenti drejtues që me lëvizjen dhe freskimin e kuadrit gazetaresk të motivojë gazetarët për një punë më cilësore dhe më kreative. Gjithashtu vlen të përmendet se me qëllim të transparencës dhe të vetëkontrollit më të madh, menaxhmenti ka kërkuar auditimin e gjendjes financiare të RTK-së nga një kompani ndërkombëtare me renome të lartë. Në këtë botim tonin mund të shihni atë që është më esenciale nga konstatimet e kësaj kompanie.

Kaq nga unë, ndërsa të tjerat do t'i shihni vetë nga ky tekst i ofruar nga ne.

Adem Demaçi

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të RTK-së

FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Me disa nga projektet më të mëdha të vitit 2002, si programi 'Mirëmëngjesi Kosovë', magazina javore në gjuhën boshnjake 'Mostovi', seriali 'Familja Moderne', transmetimi i Kampionatit Botëror të Futbollit, radio emisioni "Të flasim dhe të shkruajmë drejt shqip", krahas programeve të tjera, Radio Televizioni i Kosovës veçse ka theksuar tiparet e veta si shërbim publik. Mbulimi i suksesshëm i zgjedhjeve komunale si dhe numri i madh i transmetimeve të drejtpërdrejta të shumë ngjarjeve të vitit kanë qenë dëshmi e rritjes profesionale të radiove dhe televizionit tonë. Ndërkaq iniciimi i projektit për programin javor televiziv në gjuhën rome e ka plotësuar spektrin multietnik të RTK-së. Shërbimi i fuqishëm i lajmeve mbetet edhe më tutje karakteristikë qenësore e RTK-së si transmetues publik. Prandaj mund të thuhet se vitin 2002 e ka përshkuar ekspansioni programor, por edhe përqendrimi, ndonëse ende i pamjaftueshëm, nga profilizimi dhe ngritja e cilësisë së programeve tona.

Paralelisht me konceptimin dhe sajimin e programit, ka ecur gjithashtu edhe "ndërtimi" i këtij institucioni të rëndësishëm të Kosovës. Për historinë e shkurtër, por të dendur të RTK-së, viti 2002 ka domethënie të veçantë, sepse shënon fillimin e drejtimit të institucionit nga manaxhmenti kosovar. Në këtë periudhë janë përpiluar rregulloret e marrëdhënieve të punës dhe akte të tjera të brendshme juridike, janë aplikuar kontratat një-vjeçare bazuar në vlerësimin e cilësisë së punës, ka nisur procedura e themelimit të zyrës së prokurimit etj. Këto janë disa nga hapat kryesorë të konsolidimit të brendshëm të RTK-së.

RTK-ja tashmë përfaqëson të gjithë mozaikun social dhe etnik të Kosovës dhe i kontribon zhvillimit ekonomik, shprehjes së pluralizmit politik, diversitetit gjuhësor dhe kulturor, tolerancës ndëretnike dhe demokratizimit si dhe integritetit të shoqërisë kosovare në tërësi. Si e tillë, RTK-ja është pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e procesit historik të 'bërjes' së Kosovës në këtë fillim shekulli.

Agim Zatriqi

Drejtore i Përgjithshëm i RTK-së

HYRJE

RTK-JA SI SHËRBIM PUBLIK I TRANSMETIMIT NË VITIN 2002

Radiotelevizioni i Kosovës është institucion publik, i cili ofron shërbime në lëmin e transmetimit radioteleviziv dhe aktivitete të tjera, të definuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/13.

Fillimisht, RTK-ja është formuar në bazë të Memorandumit për Mirëkuptim ndërmjet EBU-së (European Broadcasting Union) dhe OSBE-së (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian), në vitin 1999. Është licencuar me Rregulloren 2000/36 të UNMIK-ut mbi licencimin e mediave transmetuese dhe si entitet legal është formuar me Rregulloren 2001/13 të UNMIK-ut mbi themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës si transmetues publik .

RTK-ja përbëhet nga dy kanale televizive, ai tokësor dhe satelitor, skema programore e të cilave nuk përputhet gjithmonë, dhe dy radio: Radio Kosova dhe Radio Blue Sky.

RTK-ja prodhon dhe transmeton programe në katër gjuhë.

Qëllimi i RTK-së është të arrijë shkallë sa më të lartë të shikueshmërisë, me një skemë të gjerë dhe atraktive të shërbimit publik, ku shërbimi i lajmeve dhe informatave janë elementet më të rëndësishme. Skema programore e RTK-së paraqet një balancim të programit të popullarizuar, që i dedikohet një auditori më të gjerë si dhe programit më të specializuar, që i dedikohet komuniteteve të veçanta të interesuara. Pavarësisht nga shkalla e shikueshmërisë, RTK-ja si shërbim publik përpiqet të ofrojë program për çdo qytetar.

Për vitin 2002 është synuar të rritet kohëzgjatja e transmetimit dhe të shtohet numri i programeve, duke pasur parasysh gjithmonë cilësinë.

Viti 2002 ishte vit i sfidave, i ndryshimeve dhe i të arriturave të rëndësishme të RTK-së.

PLANI I BIZNESIT 2002

Në planin e biznesit 2002 është paraparë që menaxhmenti ndërkombëtar t'ia kalojë kompetencat drejtuesve vendorë. Drejtori i Përgjithshëm, i emëruar nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së, e ka marrë detyrën që nga 1 janari 2002.

Orientimet strategjike për vitin 2002

- Mbajtja në vijimësi e operacioneve dhe e praktikës për të siguruar tranzicion të natyrshëm prej menaxhimit të EBU –së në organizatë kosovare;
- Marrëveshja me EBU-në për relacione të vazhdueshme me RTK-në, duke përfshirë këtu edhe qasjen në lajmet dhe ngjarjet sportive të Eurovizionit;
- Qëndrueshmëria financiare përmes punës me donatorë dhe kontroll rigoroz i shpenzimeve;
- Rritja e të ardhurave nga reklamat si plotësim i financimit publik dhe të donatorëve;
- Puna me KEK-un dhe me agjencitë e tjera relevante për marrëveshje lidhur me format e parapagimit të propozuar;
- Ruajtja e pavarësisë editoriale të RTK-së dhe nxitja e politikës së paanshme redaktuese;
- Zhvillimi i politikës e cila vlerëson performancën, shpërblen rezultatet e mira dhe inkurajon punën në ekip dhe përgjegjësinë menaxheriale;
- Si anëtare e KTTN-së, të angazhohet në mënyrë që KTTN-ja të përmirësojë cilësinë dhe mbështetjen e shërbimeve të transmetimit tokësor.

Synimet për vitin 2002:

- Përqendrimi në zhvillimin e programit të cilësisë së lartë, me përmbajtje informative, arsimore dhe argëtuese;
- Fillimi i programit informativ – argëtues të mëngjesit prej orës 07.00 deri në 09.30 në ditët e javës dhe nga ora 08:00 deri në 10:00 në fundjavë, përfshirë këtu lajmet dhe informatat e caktuara servitore;
- Zhvillimi i skemës së reprizave ditore për të arritur 17-orëshin e transmetimit, prej orës 07.00 të mëngjesit deri në mesnatë, ndërsa gjatë fundjavës deri në orën 2 të pasmesnatës;

- Zgjatja dhe përforcimi i transmetimit të programeve për minoritete. Fillimi i një emisioni javor në gjuhën boshnjake në tremujorshin e dytë të vitit; pranimi i gazetarëve plotësues për çdo redaksi të lajmeve në gjuhët përkatëse dhe gjetja e mundësive për këmbim të programeve me stacione të tjera televizive që kanë qëndrim dhe pikëpamje të njëjtë me RTK-në;
- Zhvillimi i njësisë për sport, planifikimi për programin sportiv të pasditës gjatë fundjavës;
- Fillimi i buletinit të lajmeve në orët e pasditës, nga 10'-15', për të plotësuar buletinet e zgjeruara në orën 19:30 dhe 10:30;
- Përqëndrimi i trajnimit mbi vlerat e gazetarisë dhe të redaktimit, administrimit të programeve me bazë në studio, prodhimi i programeve për anëtarët e rinj dhe trajnimin mbi menaxhimin e nivelit të mesëm;
- Rritja e numrit të stafit me qëllim të ngritjes së kapacitetit lidhur me përdorimin e infrastruktures teknike dhe lejimi i përdorimit të të dy studiove njëkohësisht;
- Përqëndrimi në vijimësi të programit satelitor digjital me qëllim të shërbimit të komunikimit medial radioteleviziv me diasporën;
- Vazhdimi i kërkimeve të dokumentarëve cilësorë, të programeve për fëmijë dhe të dramave nga shtëpitë e njohura transmetuese dhe prodhuese jashtë vendit;
- Nxitja e gazetarisë hulumtuese – kreative.

TELEVIZIONI

RTK-ja vazhdon realizimin e synimeve të përgjithshme programore të transmetuesit publik me programe të llojllojshme dhe të paanshme. Programet e RTK-së janë të ndërtuara mbi parimet themelore të transmetuesit publik, i cili mundëson përzgjedhje të gjerë të programeve me interes për auditorin.

Në vitin 2002, RTK-ja ka vazhduar nismën e zhvillimit programor duke zgjeruar programet e saj, si dhe duke punuar për cilësi sa më të lartë. Gjatë këtij viti, RTK-ja ka arritur të dalë nga faza emergjente programore në të cilën shfaqeshin kohëpaskohe dobësi në strukturën e përgjithshme programore. Viti 2002 ka qenë vit i konsolidimit të skemës programore me pasurimin e përgjithshëm nëpër segmente të caktuara programore, gjë që ka ndikuar në një depërtueshmëri më të madhe të RTK-së.

Numri i orëve të transmetimit si dhe numri i ngjarjeve të transmetuara drejtpërdrejt flasin për një arritje të lakmueshme. RTK-ja ka arritur që gjatë vitit 2002 të shtojë numrin e orëve të transmetimit ditor në të dy rrjetet: atë tokësor dhe satelitor prej 18-20 orë program të transmetuar

gjatë ditës. RTK-ja po ashtu vazhdon me inkurajimin e prodhimit vendor - 65% e programit të përgjithshëm është prodhim vendor.

Gjatë vitit 2002, RTK-ja ka transmetuar gjithsej 6935 orë program (duke i përfshirë edhe ritransmetimet), prej tyre përafërsisht 1750 orë program të drejtpërdrejtë nga studiot dhe autoreportazhi. Ky vëllim programor, me modifikime të imponuara nga mungesa e të drejtave për transmetim satelitor, është emetuar edhe në kanalin satelitor.

Të gjitha këto e bëjnë RTK-në kanalin më të shikuar vendor.

Të dhënat përmbledhëse:

Seanca të Kuvendit të Kosovës, të transmetuara drejtpërdrejt	26
Ndeshje të Kampionatit të Kosovës në basketboll, të transmetuara drejtpërdrejt	31
Manifestimeve të tjera kulturore, dokumentare, etj.	87
Numri i gjithëmbarshtëm i projekteve të ndryshme të realizuara me autoreportazh	292
Transmetimi i edicioneve të rregullta informative, ditore dhe javore	1450
Xhirime në të dy studiot televizive	2200orë
Programe të drejtpërdrejta	1750orë

BESUESHMËRIA DHE SHIKUESHMËRIA

Edhe gjatë vitit 2002, RTK-ja vazhdon të mbajë rejtingun që ka pasur në vitin 2001 karshi arritjeve evidente të kanaleve konkurrenente televizive. Sipas hulumtimit të bërë në tetor të vitit 2002 nga Index Kosova & Gallup International, RTK-ja ka prirë me shikueshmëri e sidomos me besueshmëri, gjë që flet për arritje të lartë profesionale, për shpejtësi dhe paanshmëri në informim. Sipas të dhënave të tetorit të vitit 2002, RTK-ja ka besueshmëri në shkallën rreth 78.6% të auditorit të përgjithshëm. Ndërkaq, sipas të dhënave të përgjithshme kumulative si përzgjedhje e parë, e dytë dhe e tretë, RTK-në e shikojnë 91.1% të auditorit. Të dhënat e hulumtimit dëshmojnë se RTK-ja ka arritur të vendosë ekuilibrin në mes të cilësisë dhe profesionalizmit në sajimin e programeve informative dhe kërkesave programore të auditorit të gjerë.

LAJMET

Gjatë vitit 2002, lajmet qendrore dhe edicioni i dytë i lajmeve "Blic", kanë shënuar suksese të dukshme. Në radhë të parë është krijuar struktura dhe fizionomia e një ditari serioz të pëlqyeshëm dhe tejet informativ. Është shënuar rritje e nivelit të përgjegjësisë, azhuritetit, vigjilencës dhe reagimit me kohë në përcjelljen e ngjarjeve.

Sipas anketave e hulumtimeve të bëra, edicioni qendror i lajmeve ishte më i shikuari nga të gjitha programet.

Është bërë mjaft në pasqyrimin e punës së institucioneve të Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare në Kosovë. RTK-ja transmeton drejtpërdrejt të gjitha seancat e Kuvendit të Kosovës duke i ofruar mundësinë për kyçe pa kompensim të gjitha stacioneve të interesuara televizive. Të gjitha shpenzimet për realizimin e transmetimeve të drejtpërdrejta të seancave të Kuvendit të Kosovës mbulohen nga buxheti i RTK-së

Ka avancuar shumë komponenti vizuel në kronikat e lajmeve. Dhe, është punuar në kronika hulumtuese, duke prekur temat dhe çështjet aktuale të cilat e preokupojnë Kosovën: kontrabanda, luftimi i kriminalitetit, korrupsioni, prostitucioni, etj.

Gjatë vitit që e lamë pas është përkrahur edhe fushata e UNDP-së dhe e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë për luftimin e AIDS-it. RTK-ja ka pasqyruar pothuajse të gjitha aktivitetet në kuadër të fushatës në edicionet e saj të lajmeve.

Gazetarët e RTK-së kanë raportuar përveç tjerash edhe prej Shkupit, Tiranës, Preshevës, Ulqinit, Berlinit, Gjenevës, Brukselit, Pragës, Nju-Jorkut, Uashingtonit, Beogradit, Lubjanës e vendeve të tjera jashtë Kosovës, prej nga kanë pasqyruar konferenca donatorësh për Kosovën, samitin e NATO-s, takime të rëndësishme të kryeadministratorit të OKB-së e shumë të tjera.

Punë e mirë është bërë sidomos me instalimin e korrespondenturës së RTK-së në Tiranë që nga fillimi i vitit 2002. Por nuk duhet harruar edhe puna e përkushtimi i ekipit për mbulimin e ngjarjeve në Luginën e Preshevës, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Gjithashtu, zyra e këmbimit e RTK-së ka kontribuar me qindra kronika nga Kosova, për ERNO-në (këmbimin rajonal) dhe për rrjetin e këmbimit të lajmeve të EBU- së.

RTK-ja ka qenë ekskluzive dhe e pranishme edhe në botë si dritare e besueshme informative për diasporën tonë, duke pasqyruar zhvillimet në dhe nga Kosova.

RTK-ja, në kuadër të programit televiziv, po ashtu transmeton edhe edicionet e Lajmeve të Radio Kosovës, në orën 10:00, 11:00, 12:00 dhe 13:00.

PROGRAMI INFORMATIV

Të gjitha seancat plenare të Kuvendit të Kosovës janë transmetuar drejtpërdrejt në rrjetin tokësor e satelitor, si dhe janë përgatitur kronika speciale nga këto seanca.

Gjithashtu, janë transmetuar drejtpërdrejt akademi përkujtimore, dy mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, janë përgatitur emisione gjithëditore me rastin e ditës së zgjedhjeve lokale e të 28 Nëntorit, etj si dhe transmetime të drejtpërdrejta të ceremonive fetare me rastin e festës së Bajramit dhe të Kërshëndellave.

Pos emisioneve të nisura një vit më parë, RTK-ja ka zhvilluar programin informativ edhe me emisione të tjera që kanë zgjeruar mjaft këtë segment programor, duke synuar gjithnjë e më shumë gjithëpërfshirshmërinë në programin informativ. Në vitin 2002, RTK-ja ka nisur projektin **Ekonomia dhe Biznesi**, si emision javor, i cili, me problemet që ka ngritur, ka ndikuar mjaft në trajtimin më të thellë të çështjeve të ekonomisë në programin informativ të RTK-së. **Intervista e Javës**, është një emision i cili, me zgjedhjen e bashkëbiseduesve kompetentë dhe autoritativë, ka trajtuar mjaft çështje që kanë të bëjnë me aktualitetin. Ndërkaq, emisioni mujor **Periskopi**, projekt i përbashkët i RTK-së dhe Deutsche Welle-s, në bashkëpunim me disa televizione rajonale, me përfshirje selektive dhe me interes për trajtimin e problemeve të rajonit, ka ndikuar mjaft në llojlojshmërinë e çështjeve të trajtuara në kuadër të programit informativ.

Emisioni **Toleranca dhe bashkëjetesa**, në kuadër të programit informativ, ka sjellë edhe një element të rëndësishëm në afirmimin e tolerancës ndëretnike në Kosovë me trajtimin e çështjeve dhe problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet e ndryshme në Kosovë.

Programi informativ vazhdon t'i kushtojë rëndësi të posaçme programeve debatuuese dhe në vazhdimësi mban debate dobiprurëse në emisione tashmë të standardizuara.

PROGRAMET E MINORITETEVE

Programi në gjuhën serbe

Redaksia në gjuhën serbe e Televizionit të Kosovës ka përgatitur rregullisht emisionin e lajmeve ditore dhe emisionin e tipit magazinë "Nedeljni Kolaz", si dhe ka realizur edhe segmente të jashtëzakonshme të programeve informative.

Lajmet, në kohëzgjatje prej 6 deri në 8 minuta, janë emetuar në termine të përhershme prej të hënës deri te e premija. Ato kanë përfshirë të gjitha ngjarjet me rëndësi ditore në Kosovë apo lidhur me Kosovën, pastaj ngjarjet në rajon dhe në botë. Për përgatitjen e lajmeve janë shfrytëzuar burime të ndryshme, në rast nevojë, raportet nga gazetarët e redaksive të tjera të RTK-së, informacionet e agjencive, të cilat janë mbuluar me xhirime nga këmbimi, dhe para së gjithash storje e reportazhe të gazetarëve të kësaj redaksie, apo raportet telefonike të korrespondentëve. Me rastin e zgjedhjeve të dyta lokale, janë dhënë edicione shtesë të lajmeve, kurse në disa raste edhe emisione speciale.

Për çdo javë pasdite është emetuar drejtpërdrejt – në kohëzgjatje prej 40 minutash – emisioni magazinë “Nedelni kolaz” (Kolazhi javor), i cili rregullisht ritransmetohet të nesërmen paradite. Përmbajtja e kësaj magazine javore është e nduarnduartë. Ndonjëherë, bashkë me kronikat, emetohen edhe spote muzikore, si dhe biseda me të ftuar nga komuniteti kosovar serb. Temat kanë të bëjnë me aspekte të jetës në mjedise të ndryshme të Kosovës, në radhë të parë nga komuniteti serb. Në mënyrë tematike, kjo redaksi është marrë me problemin e kthimit të serbëve të shpërngulur, jetën ekonomike, problemet e përditshmërisë jetësore, me ngjarjet kulturore dhe sportive. Vlen të vihet në pah se Televizioni i Kosovës, shumë herë, ka qenë i pari që ka arritur në vendet edhe më të izoluar ku jetojnë serbët.

Nga të ftuarit në magazinën javore “Nedelni kolaz” veçojmë pjesëmarrjen e kryeministrit të Kosovës, z. Bajram Rexhepi, nga fundi i qershorit 2002. Me këtë rast, pyetjeve të udhëheqëses së emisionit dhe pyetjeve të shikuesve, serbë dhe shqiptarë, brenda dhe jashtë Kosovës, drejtpërdrejt në studio z. Rexhepi iu përgjigj në gjuhën serbe; gjithashtu veçojmë debatin në të cilin morën pjesë R. Trajković dhe A. Demaçi, si dhe R. Nojkić, etj. Në prag të zgjedhjeve lokale, e ftuar në emision ishte Suzan Karndaf, drejtore e operacioneve zgjedhore të OSBE-së në Kosovë, e cila iu përgjigj pyetjeve të shikuesve drejtpërdrejt me përkthim simultan në gjuhën serbe.

Në kuadër të programit të Vitit të Ri, redaksia serbe përgatiti dhe emetoi një emision 20-minutësh “Muzicki kolaz” (“Kolazhi muzikor”). Me organizim të Zyrës Amerikane në Prishtinë është përgatitur dhe transmetuar, krahas versionit shqip edhe në serbisht, koncerti i korit multietnik për fëmijët e Kosovës.

Duhet vënë në pah, se në pjesën programore në gjuhën serbe është transmetuar dhe po transmetohet seriali australian për fëmijë “Vuf” me titrim në serbisht. Në përgatitje e sipër është edhe një serial tjetër i ngjashëm për fëmijë.

Redaksia në gjuhën serbe e Televizionit të Kosovës përpara majit të vitit 2002 ka angazhuar një korrespondent të përhershëm, i cili raporton rregullisht mbi aktualitetet në rajonin e Anamoravës dhe nga Lugina e Preshevës. Qysh prej datës 1 shtator, përmes një konkursi të rregullt, është punësuar edhe një gazetar, si dhe një xhirues, që të dy pjesëtarë të komunitetit serb. E tërë kjo ka ndikuar që në lajmet serbisht dhe në magazinën “Nedeljni kolaz” të kemi më shumë storje origjinale dhe reportazhe dhe, sipas informacionit nga terreni, këto po tërheqin gjithnjë e më shumë shikues në Kosovë.

Programi në gjuhën turke

Redaksia në gjuhën turke përgatit emisionin e lajmeve ditore “Haber” dhe një magazinë javore në gjuhën turke të titulluar “Mozaik”. Në lajmet (“Haber”) që emetohen 5 ditë në javë, gjatë vitit 2002 janë përfshirë këto ngjarje kryesore: Zgjedhjet lokale në Kosovë, punimet e institucioneve të Kosovës, ngjarjet e ditës nga Kosova, rajoni e bota, ngjarjet në arenën ndërkombëtare, zgjedhjet parlamentare në Turqi dhe lajme të tjera nga Turqia. Vend i veçantë në lajmet në gjuhën turke u është dhënë storjeve të shkurtëra lidhur me aktivitetet dhe problemet e komunitetit turk në

Kosovë. Në këtë kontekst vlen të përmendet kontributi i korrespondentëve nga Mitrovica, Gjilani e Prizreni, të raporteve ditore telefonike dhe kronikave të herëpashershme. Në kuadër të programit në gjuhën turke, në RTK emetohet çdo të shtunë rubrika Mozaik, e cila po ashtu reprizohet të nesërmen. Të ftuar në studio janë personalitete të komunitetit turk nga fusha e politikës, arsimit, kulturës etj. Brenda kësaj magazine janë pasqyruar edhe aktivitetet e partive turke në zgjedhjet lokale dhe arritjet e tyre. Përpos pikave atraktive muzikore në kuadër të magazinës javore, transmetohen edhe blloqe të shumta lidhur me problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti turk në Kosovë, arritjet në lëmenj të ndryshëm, blloqe argëtuese nga shkollat, me fëmijë dhe të rinj, si dhe kronika nga Prishtina, Prizreni, Mamusha (ku jeton një komunitet i gjerë turk), Mitrovica, Gjilani dhe Dobërçani. Ndër reportazhet ekskluzive të përgatitura nga kjo redaksi kanë qenë, arsimimi i nxënësve kosovarë në Turqi, programi jubilar "Mozaiku i 100-të", programet argëtuese (prodhim i RTK-së) për festa të ndryshme, si Bajrami, Viti i Ri, etj. Po ashtu, janë pasqyruar aktivitetet e shoqërive kulturore artistike turke. Janë transmetuar edhe një numër i konsiderueshëm emisionesh të huazuara nga televizioni turk, në bazë të Protokollit për Bashkëpunim ndërmjet RTK-së dhe TRT-së.

Programi në gjuhën boshnjake

Lajmet në gjuhën boshnjake që kanë filluar nga gjysma e dytë e vitit 2001, me vazhdimësi edhe në vitin 2002, kanë qenë një emision i shikuar informativ, që i ka kontribuar prezantimit të mozaikut të komuniteteve në Kosovë. Lajmet janë transmetuar 5 herë në javë, nga 8 minuta, në orën 17:30 nga e hëna në të premte.

Sipas informacioneve nga terreni (letrave të shikuesve, etj.) këtë program nuk e ndjekin vetëm boshnjakët, por edhe grupet e tjera etnike, të cilat e kuptojnë këtë gjuhë. Lajmet përmbajnë informacione kryesore nga Kosova, nga rajoni, bota, me orientim që të transmetohen tema, të cilat u interesojnë më së shumti boshnjakëve të Kosovës.

Në Redaksinë boshnjake aktualisht punojnë tre veta, ndërkohë që për emisionin e lajmeve punojnë edhe korrespondentët nga Prizreni, Mitrovica e Peja.

Më 14 qershor 2002, RTK-ja ka startuar edhe me një emision të tipit të magazinës javore në gjuhën boshnjake me titullin "Mostovi" (Urat). Me qasjen e vet ky emision bën përpjekje për rindërtimin e urave të e shkatërruara mes njerëzve dhe popujve. Gjatë vitit 2002 janë emetuar gjithsej 29 emisione "Mostovi" në kohëzgjatje prej 40-45 minutash. Emisioni është reprizuar të shtunave në orën 11. Në këtë emision fokusohen një a dy ngjarje të javës, që mund të jenë nga Kosova, por edhe nga rajoni, apo bota. Pjesa e emisionit "Ju prezantojmë" paraqitet tema nga mjediset boshnjake. Tema të tjera pasqyrojnë aspekte nga arsimit, shëndetësia, ekonomia, infrastruktura. Redaksia boshnjake ka mbuluar tubimet e partive politike boshnjake, si dhe tubimet nga shoqëria civile kushtuar integritet të komuniteteve minoritare në Zhupë, Dragash e Prizren. Gjatë fushatës zgjedhore në "Mostovi" janë prezentuar subjektet elektorale boshnjake, si koalicioni "Vatan", BSDAK, SDA, etj.

Programi në gjuhën rome

Me qëllim të përfaqësimit sa më të plotë të minoriteteve në strukturën programore të RTK-së, Televizioni i Kosovës, në vitin 2002, ka përfunduar sajimin e projektit për të filluar një magazinë javore në gjuhën rome. Implementimi i këtij projekti fillon në vitin 2003.

PROGRAMI ARGËTUES DHE MUZIKOR

Programi argëtues dhe muzikor përbën një segment të rëndësishëm në përmbajtjen e tërësishme programore të RTK-së. Programet muzikore, argëtuese, filmat dhe serialet, transmetimet e spektakleve të mëdha në botë dhe në vend, formojnë boshtin kurrizor të kësaj redaksie. RTK-ja ka bërë transmetimin e drejtpërdrejtë të shumë ngjarjeve muzikore në Kosovë; nga koncertet e Filharmonisë së Kosovës e deri te koncertet e muzikës argëtuese e popullore.

Në këtë kuadër përmendim edhe transmetimin i spektakleve të mëdha në Shqipëri, **Dua më shumë Shqipërinë** dhe festivalet e mëdha të muzikës së lehtë shqiptare **Kënga Magjike** dhe **Festivali i Këngës në RTSH**.

Koncerti i Vjenës i Vitit të Ri, Ndarja e çmimit Oskar, Kënga e Eurovisionit etj, janë vetëm disa nga ngjarjet e mëdha botërore të transmetuara profesionalisht në RTK.

Ndër sukseset më të mëdha të RTK-së në vitin 2002, është pa dyshim prodhimi i serialit të parë vendor pas lufte **Familja moderne**. Shumë shpejt, seriali Familja Moderne është shndërruar në program shumë atraktiv, ndër më të shikuarit në Kosovë, nëse jo më i shikuari.

Gjatë verës cikli i emisioneve argëtuese **Air Condition** është ndjekur me interesim shumë të madh nga publiku.

Cilësia e programit filmik dhe serialeve në RTK-së ka qenë dallueshëm më lart se në vitet e mëparshme. Këtu duhet theksuar se në vitin 2002 RTK-ja ka hequr seritë latino-amerikane nga programi, dhe ka filluar transmetimin e një serie të cilësisë së lartë të prodhimit amerikan **JAG**.

PROGRAMI KULTUROR-ARSIMOR

Programi Kulturor, Artistik, Dokumentar dhe për Fëmijë ka synuar t'i përmbushë përcaktimet programore, duke ruajtur si orientim gjithëpërfshirshmërinë në trajtimin e aspekteve të ndryshme të kulturës dhe artit; prej letërsisë, teatrit, arteve pamore deri tek debatet kulturore me rëndësi të veçantë. Në emisionet **Dialog plus, Kulti, Pro arte, Labirintet e fjalës, Ateleu** dhe **Mendimi pozitiv** është krijuar mjaft hapësirë për trajtime të shumanshme të kulturës dhe artit si dhe për avancimin përmbajtësor të këtij segmenti programor. Përveç këtyre emisioneve me dinamikë të rregullt të transmetimit, ky segment programor ka realizuar edhe speciale për filmin dokumentar **Mjaft lot, o Zot**, prodhim i RTK-së, dhe për filmin **Parullat** të Gjergj Xhuvanit, si dhe Programin special të drejtpërdrejt më se tre orësh, nga mjediset e Kinemasë ABC të kryeqytetit, kushtuar dokumentarit **Gjuhë që nuk vdes** të Viktor Gjikes, etj.

Janë shënuar edhe disa rezultate të rëndësishme në sferën e Programit dokumentar, qoftë me prodhime vetjake, apo në ko-produksion, siç janë dokumentarët: **Mjaft lot, o zot, Ripërritje, Jetimat e Kosovës, Në rrugën e idealit kombëtar**, tre dokumentarë kushtuar **Kongresit të drejtshkrimit**, disa dokumentarë kushtuar dëshmorëve etj. Dokumentari **Ripërritje**, prodhim i RTK-së, në ko-produksion me disa stacione të tjera nga rajoni dhe Evropa, është shpallur më i miri në konkurrencën e gjashtë qendrave televizive të rajonit, që u mbajt në Ohër të Maqedonisë.

Sa i takon Programit për fëmijë, mund të jemi të kënaqur me cilësinë e emisioneve: **Fjolla** dhe **Kutia Magjike**, por ende jo edhe me sasinë e prodhimeve. Vëllimi programor kushtuar fëmijëve është plotësuar me emisione të huajtura.

PROGRAMI I MËNGJESIT

Programi i mëngjesit **Mirëmëngjesi Kosovë** është një prej projekteve më të mëdha dhe me rëndësi të posaçme në zhvillimin programor të RTK-së. Ky program informativ - argëtues ka filluar më 24 prill 2002 si transmetim i drejtpërdrejtë me kohëzgjatje dy orë e gjysmë nga 07.00-09.30 të hënë deri të premte, dhe nga 08.00-10.00 të shtunë e të dielë. **Mirëmëngjesi Kosovë** ka një format atraktiv dhe një strukturë të konceptuar që plotëson nevojat e shumta të auditorit. Ky program përmbajtësisht i pasur me elemente të shumta të informimit dhe argëtimit, përmbledh tri edicione lajmesh 10 minutëshe, informacione servitore, muzikë, mysafirë në studio, ushtrime të mëngjesit, parashikim të motit, etj. Ky format është mjaft i pëlqyeshëm që e dëshmon shikueshmëria e lartë dhe vlerësimi i audiencës. Këtë program e plotëson edhe sasia e informacioneve për ngjarjet nëpër komuna. Për këtë qëllim, RTK-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me televizionet lokale gjë që mundëson një qasje shumë më të shpejtë, jo vetëm informative, por edhe vizuele nga komunat e Kosovës.

SPORTI

Meqë në Kosovë ka një interesim të madh për sportin, RTK-ja i jep hapësirë të madhe dhe investon mjaft në këtë segment programor. RTK-ja vazhdon të përcjellë ngjarjet më të mëdha sportive dhe përpiket që me mundësitë e veta buxhetore të transmetojë sa më shumë aktivitete sportive. Viti 2002 ka qenë vit i ngjarjeve të mëdha sportive, të cilat RTK-ja i ka transmetuar. Nga 'kulmet' sportive të arenës ndërkombëtare mund të veçohet Kampionati i 17-të Botëror në futboll në Japoni dhe në Korenë e Jugut, prej të cilit, në rrjetin tokësor, janë transmetuar gjithsej 64 ndeshje, si edhe ngjarjet kryesore nga Lojërat Dimërore Olimpikë, në Salt Lake City. Në skemën programore të vitit 2002 iu dha hapësirë edhe atletikës. Transmetimi i drejtpërdrejtë, në rrjetin tokësor, i shtatë mitingjeve të "Ligës së Artë" në qytetet më të njohura të Evropës, zgjoi interesim të madh te sportdashësit.

Sporti më i popullarizuar aktualisht në Kosovë – basketbolli, ka gjetur pasqyrim adekuat. RTK-ja ka transmetuar ndeshjet më interesante, duke përfshirë edhe garat e plej-ofit. Natyrisht, edhe disa nga ndeshjet futbolistike të ligës së Kosovës kanë mundur të ndiqen në RTK.

RTK-ja ka transmetuar drejtpërdrejt ndeshjen e parë miqësore të zhvilluar mes Kosovës dhe Shqipërisë. Nga ngjarjet e sportit kosovar duhet veçuar transmetimi i drejtpërdrejtë i lojës hendbollistike mes përfaqësueses së Kosovës dhe Egjiptit.

Boks-meçi i kategorisë së rëndë për titullin e kampionit të Evropës mes Luan Krasniqit dhe Rene Monsenit, në Magdeburg të Gjermanisë është transmetuar drejtpërdrejt për kënaqësinë e sportdashësve.

Megjithë numrin mjaft të madh të transmetimeve të drejtpërdrejta të ngjarjeve të mëdha sportive, vendore dhe ndërkombëtare, programi sportiv në RTK nuk ia ka dalë që t'i përcjellë ato me emisione analitike, debatuuese dhe informative, që do të plotësonin dhe ngrinin në nivel të duhur këtë program. Për më tepër, RTK-ja është kritikuar për një qasje jo gjithmonë objektive në komentime të ngjarjeve sportive, kryesisht të atyre vendore.

NGJARJE TË VEÇANTA

Zgjedhjet 2002

Duke i cilësuar zgjedhjet e pushtetit lokal të Kosovës, më 26 tetor 2002, si angazhimin më të rëndësishëm programor të vitit, RTK-ja ka ndërtuar strategjinë për pasqyrimin sa më të plotë dhe cilësor të fushatës së zgjedhjeve komunale.

Për këtë qëllim, RTK-ja ka formuar Redaksinë e veçantë dhe ka miratuar konceptin programor. Është caktuar ekipi zgjedhor, është siguruar hapësirë e posaçme, si dhe janë siguruar kapacitete të veçanta teknike dhe logjistike për redaksinë e Zgjedhjeve.

Në skemën programore, për çdo mbrëmje, është paraparë dhe aplikuar termini i Emisionit special - **Zgjedhjet Komunale 2002**. Çdo ditë, nga katër ekipe ENG (gazetari, xhiruesi dhe vozitësi) kanë ndjekur në terren aktivitetet e subjekteve politike, tubimet parazgjedhore, nga janë përgatitur kronikat zgjedhore për edicionet informative në shqip, serbisht, turqisht dhe boshnjakisht, si dhe një version më i gjatë për emisionin special kushtuar zgjedhjeve. Si bllok i posaçëm janë transmetuar **Debatet në Studio** dhe **Debatet Qytetare** nga disa qendra komunale. Gjatë fushatës zgjedhore RTK-ja ka organizuar 39 debate me kandidatët elektorale nga komunat e Kosovës, si dhe 7 debate të drejtpërdrejta me qytetarë nga qendra të ndryshme komunale në bashkëpunim me OJQ "The Forum".

Tubimet parazgjedhore janë pasqyruar duke respektuar rregulloren e OSBE-së për përcjelljen e aktiviteteve parazgjedhore.

Përcjellja e aktiviteteve parazgjedhore të subjekteve politike është bërë në bazë të klasifikimit të tyre në pesë grupe dhe në pajtim me këtë sistem u është kushtuar rëndësi dhe hapësirë në edicionet e lajmeve dhe në emisionin special.

Ditëve pa aktivitete të ngjeshura parazgjedhore, ekipet e xhirimit përgatisnin kronika-anketa me qytetarë, biseda me zyrtarë të OSBE-së, analistë, gazetarë, etj.

Ditën e zgjedhjeve, më 26 tetor, RTK-ja ka përgatitur program gjithëditor të drejtpërdrejtë informativo-zbavitës, të gërshetuar me informacione dhe me pika e kollazhe muzikore, duke filluar nga ora 07.00 e mëngjesit deri në orët e pasmesnatës.

Ekipet televizive janë inkuadruar drejtpërdrejt 15 herë nga pika të ndryshme të Prishtinës, për të regjistruar atmosferën, disponimin dhe opinionet e qytetarëve.

Gjatë ditës, korrespondentët e RTK-së nga terreni janë ndërlidhur me qendrën.

Në studio kanë qenë të ftuara personalitete të njohura publike dhe të estradës.

Në përgjithësi, në saje të organizimit të mirë dhe efikas, janë pasqyruar të gjitha tubimet e rëndësishme parazgjedhore të partive politike. Është vënë një komunikim i mirë, i rregullt ditore me subjektet elektorale.

Janë ndjekur drejtpërdrejt konferencat e OSBE-së, gjatë prezantimeve të rezultateve preliminare dhe ato përfundimtare, programe speciale me rezultatet paraprake të KMDLNJ-së.

Përgjithësisht, gjatë fushatës, përfaqësuesit e subjekteve elektorale kanë shprehur kënaqësinë e tyre me mbulimin e aktiviteteve, duke e cilësuar punën e gazetarëve tanë si korrekte, të paanshme dhe profesionale.

Programi i Vitit të Ri

Për dallim nga vitet e tjera, në vitin 2002, RTK-ja ka transmetuar program të produktionit të vet, pothuajse pa asnjë reprizë dhe pa ndërprerje gjatë tri ditëve të festës së Vitit të Ri. Sasia dhe kualiteti i prodhimit, pa asnjë dilemë, ka tejkaluar të gjitha parashikimet dhe rezultatet e arritura deri më tash. Programi i Vitit të Ri 2002 është ndërtuar mbi bazat e një koncepti të ri programor, që ka mundësuar funksionim shumë të mirë të të gjitha tërësive programore, duke filluar nga programi i mëngjesit, i rikonceptuar enkas për ditët festive, me shumë mysafirë, këngë dhe rubrika speciale. Kombinimi i prodhimit tonë të programeve për fëmijë me filma të huazur artistik, u ka mundësuar fëmijëve të shohin dhe të kënaqen me diçka të mirë për ta në këto ditë feste. Edicioni festiv i serialit shumë të popullarizuar, Familja Moderne, dhe më pas pikat muzikore të këngëtarëve më të mirë kosovarë, të zgjedhur me kritere të larta profesionale, blloku i shkëlqyer i këngëtarëve nga Shqipëria dhe kompilacionet speciale muzikore të interpretuara nga aktorë, manekenë e sportistë, e kanë bërë programin e këtyre netëve të ndërrimit të motmoteve të paharrueshëm. Maratona filmike gjatë tri netëve të festës, pastaj transmetimi i koncertit tradicional të Vjenës dhe programet muzikore zbavitëse në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake vetëm sa e kanë ngritur edhe më shumë cilësinë dhe larushinë e programit të Vitit të Ri.

SHPËRBLIMET

Radiotelevizioni i Kosovës gjatë vitit 2002 ka fituar 2 herë radhazi shpërblimin e parë të Këmbimit Rajonal të Evropës Juglindore - ERNO.

Për herë të parë, gjatë takimit të rregullt në Vjenë, në qershor të vitit 2002, RTK-ja me kronikën **Shtetësia** fitoi çmimin e parë - **“Kronika më e mirë”**. Kjo kronikë, në lajmet qendrore të RTK-së, është transmetuar në dy kronika të veçanta – e para e realizuar nga Xhymret Veliu, ku trajtohet shpërndarja e pasaportave maqedonase qytetarëve goranë në komunën e Dragashit. Ndërsa, kronika e dytë, e realizuar nga Lindita Azizi bënte fjalë për shqiptarët e dëbuar nga Maqedonia në Kosovë, të cilët pa dokumente nuk mund të kthehen në vendlindjet e tyre në Maqedoni. Këto dy kronika pastaj janë rikomponuar në një kronikë e cila është transmetuar në ERNO. Komisioni për vlerësimin e kronikave – në përbërje të gazetarëve të njohur nga shumë vende të Evropës (suedezë, norvegjezë, danezë, gjermanë, anglezë, etj.) e ka vlerësuar kronikën e RTK-së me çmimin e parë.

Për herë të dytë, RTK-ja, gjatë takimit të rregullt të ERNO-s, në Athinë, në dhjetor 2002, sërish fitoi vendin e parë – **“Kronika më e mirë”**. Por, kësaj radhe jo për një kronikë, por për disa kronika, në mesin e të cilave ishin kronikat: **“Sociale”** – jeta e një familje në Drenicë, e realizuar nga Mimoza Zajmi, **“Ekologji - prerja e pyjeve dëmton ekosistemin”** dhe **“Kontrabanda”** të realizuara nga Fatos Bytyçi, si dhe **“Hekurudhat e Kosoves”** e realizuar nga Zekë Sinani. Të gjitha këto, dhe kronikat e tjera, janë rikomponuar dhe përpunuar për t’iu përshtatur standardeve të këmbimit në Eurovizion, nga desku i EVN-it dhe janë transmetuar në ERNO.

RTK-ja, po ashtu, ka fituar edhe çmimin vendor për kronikën dhe reportazhin më të mirë të vitit në televizion, të cilën e jep, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës dhe Qendra për Studime Humanistike “Gani Bobi”. Autor i kronikës është Fatos Bytyçi.

RADIO

Brenda RTK-së punojnë me sukses edhe dy radiostacione: **Radio Kosova** dhe **Radio Blue Sky**. Këto radio konsiderohen të jenë pjesë e rëndësishme e RTK-së si transmetues publik. Të dyja radiot, si shërbime publike, u ofrojnë dëgjuesve programe të plota informative, edukative dhe argëtuese. Radio Kosova dhe Radio Blue Sky edhe pse me qasje dhe profile të ndryshme janë komplementare në tërheqjen e auditorit.

Radio Kosova, i drejtohet auditorit të moshës mbi 25-vjeç, ndërsa Radio Blue Sky moshës deri në 25-vjeç.

Gjatë vitit 2002, në radion Blue Sky ka filluar transmetimi i nëntë emisioneve të reja.

Në Radio Kosovë ka vazhduar digjitalizimi i Arkivit. Deri më tash janë digjitalizuar 3 mijë e 500 njësi muzikore.

Po ashtu, ka vazhduar trajnimi i gazetarëve në vend dhe jashtë. Gazetarët tanë kanë vijuar kurset e trajnimit për gazetari hulumtuese në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të gruas, në lëmin e eliminimit të armëmbajtjes pa leje, për mënyrën e raportimit gjatë fushatës elektorale, etj.

Gjatë vitit 2002, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë realizuar 215 transmetime të drejtpërdrejta. Shumica e transmetimeve të drejtpërdrejta, gjithsej 185, janë bërë nga ngjarjet sportive. Radio Blue Sky ka transmetuar drejtpërdrejt një mbrëmje të organizuar në Prishtinë. Prezentimi teorësh është bërë nga një D.J. i njohur nga Gjermania dhe D.J. të tjerë nga Maqedonia e Kosova, në praninë e mbi 2 mijë të rinjve.

Transmetimet kryesore:


- Koncerti tradicional i Filharmonisë së Vjenës
- Shën Valentini, Program argëtues i natës
- Falja e Bajramit
- Shpallja e z.Bernard Kushner Doktor Nderi i Universitetit të Prishtinës
- Mbledhja solemne e Kuvendit Komunal te Prishtinës
- Zgjedhjet në Kosovë
- Tri konferencat e Komisionit Qendror Zgjedhor
- Dita e Flamurit
- Dita e Bajramit
- Mesha e Krishtlindjeve
- Tri transmetime të Kuvendit të Kosovës

BESUESHMËRIA DHE DËGJUESHMËRIA


Rezultatet e publikuara nga Index Kosova & Gallup International tregojnë se radiot tona kanë shënuar një ngritje të dëgjueshmërisë dhe të besueshmërisë tek auditori.

Dy radiot tona janë ndër tri të parat sa i përket dëgjueshmërisë. Radio Kosova mbetet në vendin e dytë për nga dëgjueshmëria, kurse radio Blue Sky është në vendin e tretë. Në vitin 2001, radio Blue Sky ishte në vendin e pestë. Ndërkaq sa i përket besueshmërisë, Radio Kosova zë bindshëm vendin e parë në konkurrencën e të gjitha radio-stacioneve në Kosovë.

DËGJUESHMËRIA



BESUESHMËRIA



Dëgjueshmëria është rritur edhe tek kategoria e dëgjuesve që e ndjekin programin tonë përmes internetit. Sipas statistikës së provajderit Live365.com, Radio Kosova dëgjohej në internet rreth 50 mijë orë në muaj, kurse radio Blue Sky mbi 4 mijë orë.

Prej tetorit të vitit të kaluar ka patur rritje të madhe të dëgjueshmërisë, sidomos në diasporë, në saje të transmetimit të programit të radios përmes rrjetit satelitor ku transmetohet programi televiziv i RTK-së. Kjo dëshmohej me shtim të madh të telefonatave dhe postës elektronike nga shtetet e ndryshme të Evropës dhe të botës.

LAJMET

Në Radio Kosovë dhe në Blue Sky shërbimi i lajmeve funksionon nga ora 6 e mëngjesit deri në mesnatë, sipas nevojës edhe në orët e pasmesnatës. Emisionet informative transmetohen në çdo gjysmë ore. Gjatë vitit 2002 është arritur shkallë e lartë profesionale e përgatitjes dhe transmetimit të lajmeve. Analiza e edicioneve të lajmeve në të dy radiot dëshmon se mbi 60% e lajmeve janë të reja, apo të azhuruara. Anketat me dëgjuesit tregojnë se emisioni qendror i lajmeve në Radio Kosovë, Ngjarjet e ditës, në orën 15:00, dyfishon numrin e dëgjuesve. Ndërkaq, Specialja e ditës në emisionin kryesor të lajmeve në Blue Sky u ofron dëgjuesve informacione të gazetarisë hulumtuese mbi problemet e mprehta në shoqëri, si krimi i organizuar, etj.

Vazhdojnë përpjekjet në Radio Kosovë dhe në Radion Blue Sky për shfrytëzimin racional të resurseve teknike e njerëzore. Transmetimet e përbashkëta, këmbimi konstant i storjeve e raporteve, koordinimi ditor dhe planifikimi i përbashkët i punës rezultojnë me lajme të mira dhe program të pëlqyeshëm në të dy radiot, duke shfrytëzuar resurset e përbashkëta.

PROGRAMI I MINORITETEVE

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky transmetojnë programe për minoritetet që jetojnë në Kosovë. Blue Sky transmeton çdo ditë një orë e gjysmë program në gjuhën serbe. Gjatë emitimit të këtij programi kryesisht jepen informacione dhe lajme që trajtojnë çështjet me të cilat ballafaqohet komuniteti serb në Kosovë. Gjatë kësaj kohe transmetohet muzikë argëtuese e produksionit botëror dhe atij serb.

Gjatë vitit 2002, janë bërë përgatitjet që programi në gjuhën serbe në radion Blue Sky në vitin 2003 të zgjerohet edhe për gjysmë ore.

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky transmetojnë dy orë program në gjuhën turke. Redaksia turke është duke përfituar nga Protokollin i nënshkruar midis RTK-së dhe TRT-së. Në sajë të këtij Protokollin sigurohen materiale muzikore dhe sajime programore nga TRT-ja.

Redaktorët dhe gazetarët e shërbimeve në të gjitha gjuhët punojnë së bashku në dhomën e lajmeve. Storjet këmben rregullisht midis të gjitha redaksive në të dyja radiot dhe të gjitha

redaksitë inkurajohen që të kuptojnë pikëvështrimin e të tjerëve dhe të jenë kritik, por edhe objektiv në raportimin për komunitetin e tyre.

Të dyja redaksitë në gjuhët e minoriteteve kanë korrespondentët që raportojnë nga zonat e popullatës minoritare. Po ashtu ekziston një bashkëpunim shumë i mirë me redaksitë e minoriteteve që punojnë në Televizionin e Kosovës.

SPORTI

Me 185 transmetime të drejtpërdrejta të ngjarjeve më të rëndësishme sportive në vend dhe me katër emisione të rregullta javore për sportin, Radio Kosova vazhdon me siguri të plotë të jetë radiostacioni numër një edhe sa i përket sportit.

Transmetimi i drejtpërdrejtë i ndeshjeve të futbollit të Ligës së Parë të Kosovës nga reporterët e Radio Kosovës dhe me inkuadrimin e korrespondentëve e të bashkëpunëtorëve ka siguruar një dëgjueshmëri maksimale të programit.

Edhe transmetimi i ndeshjeve të basketbollit kosovar – sportit më të popullarizuar gjatë vitit 2002 - është ndjekur me interesim shumë të madh nga dëgjuesit.

Redaksia e sportit e Radio Kosovës ka regjistruar edhe disa rezultate të veçanta programore, duke realizuar një cikël emisionesh të drejtpërdrejta nga qendrat kryesore komunale të Kosovës.

Edhe emisioni **Sport Billy** në Radion Blue Sky, ndonëse është një “talk show”, ofron hapësirë në të cilën dëgjuesit mund të shprehin mendimet e tyre përkitazi me sportin dhe ngjarjet sportive. Kjo vlen sidomos për dashamirët e sportit nga gjenerata e re.

SHPËRBLIMET

Në fund të vitit 2002 dhe në janar të këtij viti, gazetarët e radiove tona kanë fituar këto shpërblime, për punë cilësore:

Radio Blue Sky - Çmimi i parë për emisionin e përgatitur gjatë fushatës kundër AIDS-it – organizuar nga UNDP, gazetarja Vahide Morina,

Radio Kosova – Çmimi i parë në Konkursin vjetor të Asociacionit të Gazetarëve të Pavarur të Kosovës - gazetarja Hyrë Tejeci,

Radio Blue Sky – Çmimi i parë për gazetari të guximshme në Konkursin vjetor të Asociacionit të Gazetarëve të Pavarur të Kosovës - gazetarja Anamari Repiq,

Radio Kosova & Radio Blue Sky- Shumë mirënjohje në fund të vitit 2002 nga asociacionet sportive, kulturore, shoqata, OJQ-të, etj.

WWW.RTKLIVE.COM

Projekt tjetër me rëndësi për RTK-në është hapja e web-faqes. Për rëndësinë e këtij projekti dhe nevojën për të plotësuar kërkesat për informim të auditorit nga burimet e RTK-së flet edhe numri shumë i lartë i vizitorëve të kësaj faqe. Nga data e hapjes, më 29 korrik 2002 e deri më 31 dhjetor 2002, web-faqja www.rtklive.com ka pasur gjithsej 807.683 vizitorë. Ky numër i vizitorëve mund të mos jetë i plotë, pasi që llogaritet një numër më shumë për çdo IP që hyn në faqen tonë gjatë 24 orëve. Duke pasur parasysh hyrjen nga një IP disa herë brenda ditës, si dhe rastin që në Kosovë një IP i mbulon, jo rrallë, qindra kompjuterë, ky numër realisht do duhej të ishte shumë më i lartë. Nga lajmet në video – format, edicioni qendror i lajmeve të orës 19:30 ka pasur 175.734 qasje, Lajmet e mëngjesit kishin 22.688, kurse **Blic**-i numëron 16.805. Lajmet e minoriteteve **Vesti**, në gjuhën serbe, kishin 3023 qasje, **Haber**, në gjuhën turke, 1351 dhe **Vijesti** në gjuhën boshnjake, 2402 qasje. Forma tjetër e plasimit të informacioneve të formatit të agjencive, (lajme me tekst), ka pasur gjithsej 1410. Përveç informacioneve në web-faqen tonë janë plasuar rregullisht edhe prodhimet e RTK-së, si **Familja Moderne**, **Ditari i Stupcave** dhe kohëpaskohe edhe emisione të tjera, si: **Ngjyra Jete**, **Intervista e javës**, dhe të gjitha emisionet speciale. Në web-faqe janë bërë rregullisht anketa me përmbajtje të ndryshme, të rëndësishme për vlerësimin e punës së RTK-së dhe segmenteve të veçanta programore, si dhe anketa rreth çështjeve të rëndësishme aktuale. Është kultivuar edhe rubrika e opinionëve të vizitorëve si dhe forma të tjera të natyrës së faqeve të internetit, si: Komentet - Opinionet e lexuesve në lidhje me temat aktuale; Forumi - diskutimi virtual interaktiv mes vizitorëve; Chat - dhoma e lirë e diskutimeve të drejtpërdrejta. Azhurimi i lajmeve në video format ka qenë i rregullt. Ndërkohë, mbetet ende për t'u punuar rreth lajmeve me tekst të formatit të agjencive. Funkionimi eventual i rrjetit unik dhe vendosja e komunikimit permanent midis tri dhomave të lajmve - të TVK-së, Radio Kosovës dhe Radios Blue Sky, si dhe shtimi eventual i stafit të aftësuar për gazetari të internetit, do të mundësonin që rtklive.com, duke shfrytëzuar kapacitetet e RTK-së, të jetë prijëse e lajmeve të formatit të agjencive në Kosovë.


Radio Kosova dhe Radio Blue Sky në Internet

Që nga viti 2001 Radio Kosova dhe Radio Blue Sky janë prezente me web-faqe në internet. Po ashtu, programet e të dy radiove kanë qasje të drejtpërdrejtë në internet dhe dëgjuesit tanë mund të përcjellin programet e të dy radiove. Për transmetim të programit në Internet shfrytëzohet servisi i provajderit live365, i cili aplikon mënyrën e parapagimit, varësisht nga numri i dëgjuesve. Në ditën e mbajtjes së seancës së parë të Parlamentit të Kosovës, (10 dhjetor 2001), në Radio Kosovë ka pasur 248 dëgjues në internet. Gjatë tërë vitit 2002, Radio Kosova dhe Radio Blue


Sky kanë pasur një ngritje në shkallën e dëgjueshmërisë përmes Internetit. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet se për bashkëdhetarët tanë në Suedi, ku nuk lejohet instalimi i antenave satelitore, si dhe në disa rajone të tjera, Interneti dhe Radio Kosova është i vetmi burim i informimit nga vendlindja.

Duhet të theksohet se në web-faqen e Radios Blue Sky jepen dhe ripërtërihen çdo ditë lajmet me tekst të të dy radiove. Po ashtu, ka një bashkëpunim të ngushtë të web-faqes së radiove me atë të Televizionit të Kosovës, si pjesë të të njëjtit transmetues publik.

Grafikoni ditor i vizitorëve të web-faqes së RTK-së



Grafikoni mujor i vizitorëve të web-faqes së RTK-së



SHËRBIMET E PËRBASHKËTA TË RTK-SË

ADMINISTRATA

Politika administrative e RTK-së implementohet duke harmonizuar dhe vënë në jetë parimet qenësore të Radiotelevizionit të Kosovës si Transmetues Publik, siç janë: transparencja, gjithanshmëria, llojllojshmëria, pavarësia editoriale, tipare këto mbi të cilat është ndërtuar identiteti i RTK-së në tregun kompetitiv medial të Kosovës.

Parimet e përmendura më lart implementohen në të gjitha fushat përkatëse brenda RTK-së. RTK-ja është transmetues publik dhe udhëheq një politikë transparente dhe racionale kadrovike duke kërkuar norma të cilësisë së lartë të kualifikimeve dhe shkathtësive profesionale për të punësuarit. Procesi i rekrutimit të stafit, i kërkimit, përzgjedhjes dhe i punësimit në RTK, në radhë të parë synon harmonizimin e potencialit njerëzor me nevojat programore, strategjike dhe operacionale të organizatës, duke e mundur shfrytëzimin e plotë të këtij potenciali dhe përparimin e vazhdueshëm të tij.

Për të mundur punësim transparent dhe konkures në RTK, sipas rregullit, konkursi është procedurë e zakonshme për t'u pranuar në punë. Konkursi publikohet në mediat ku vërehet më së shumti, në mënyrë që të konkurojnë sa më shumë persona dhe të rekrutohen më cilësorët.

Me qëllim të menaxhimit racional me mjetet buxhetore, RTK-ja, për ato vende të punës për të cilat nuk është e domosdoshme prania e punëtorit në mënyrë permanente, angazhon staf periodik me kontratë mbi veprën.

Gjithashtu, RTK-ja i kushton rëndësi trajnimit permanent të të punësuarve, në të gjitha nivelet, në harmoni me prioritetet e caktuara me plan të biznesit, për kandidatë që kanë afinitet për atë lëmi, dhe nevojë për trajnim. Organizimi i trajnimeve bëhet në mënyrë fleksibile me qëllim të korrespondimit me nevojat që shfaqen, duke pasur parasysh që RTK-ja ende është në fazë të zhvillimit.

Ekzistojnë tri nivele të organizimit të trajnimit në RTK:

- trajnim për aftësim fillestar për të punësuarit e rinj,
- trajnime të ndërlidhura me veçantitë e zhvillimit të strukturave të reja programore,
- trajnime për ngritjen e aftësisë në gazetari, produksion-teknikë dhe në lëmin e udhëheqjes.

Synim themelor i RTK-së është që të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për punë profesionale, ku kontributi i çdonjërit punëtor do të vlerësohet në mënyrë të drejtë, me kujdes dhe respekt.

RTK-ja ka për qëllim t'i tërheqë dhe t'i angazhojë individët me aftësi të nevojshme (njohuritë, shkathtësitë dhe cilësitë) brenda organizatës.

RTK-ja gjithnjë krijon një mjedis që iu ofron mundësi të barabarta të gjithë të punësuarve, si dhe kushte për përparim të mëtejshëm brenda RTK-së. Vendet e punës në RTK plotësohen me kandidatët më të përshtatshëm, më të kualifikuar, gjithnjë duke pasur parasysh respektimin e politikës së RTK-së, për implementimin e punësimit racional, duke harmonizuar nevojat dhe qëllimet me vëllimin e punëve, me qëllim të shmangies së tejpunësimit në RTK.

Duke filluar nga janari i vitit 2002 dhe bazuar në Rregulloren 2001/13 mbi Themelimin e Radio Televizionit të Kosovës, RTK-ja për herë të parë ka filluar të menaxhohet nga stafi vendor. Gjatë këtij viti janë janë plotësuar vakumet juridike-administrative, përmes hartimit të procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të brendshme të RTK-së, në përgjithësi dhe në çdo sektor në veçanti, të cilat kanë qenë evidente më parë. Menaxhmenti vendor i RTK-së, nga 1 janari 2002, ka shndërruar kontratat e përhershme mbi punësim në kontrata njëvjeçare të punës, gjithnjë duke u nisur nga krijimi i mundësisë për të punësuarin që vazhdimisht të konfirmojë dhe ngrisë kualitetin, kuantitetin, shkathhtësitë dhe përgjegjësinë në vendin e punës. Nisur nga kjo premisë, ka filluar aplikimi i vlerësimeve të punës së të punësuarëve në RTK, në bazë të cilit të gjithë të punësuarit gjatë kohëzgjatjes së kontratës, kalojnë nëpër procedurën e vlerësimit me shkrim të punës së tyre, çdo gjashtë muaj.

Në fund të vitit 2002, numri i përgjithshëm i të punësuarve të rregullt në RTK, ishte 311, prej të cilëve 206 të punësuar në Televizionin e Kosovës dhe 105 në Radio Kosovë e Radio Blue Sky.

RTK-ja i kushton rëndësi të veçantë angazhimit të femrave në të gjitha segmentet e veta. Në vitin 2002 në RTK, kanë qenë të punësuar gjithsej 86 femra me kontrata të rregullta. Nga ky numër, në Televizionin e Kosovës ka pasur gjithsej 56 të punësuar, prej të cilave në sektorin Programor 30, në sektorin e Operacioneve Teknike 18, në sektorin e Administratës 7 dhe në sektorin e Financave 1 femër. Ndërkaq, në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky gjithsej ka pasur 29 femra të punësuar, prej të cilave në sektorin Programor 24, në sektorin e Operacioneve Teknike 2 dhe në sektorin e Administratës 3 femra.


Mesatarja e moshës së të punësuarve në RTK, në Televizion dhe në të dyja radiot është 34.20. Vetëm në Televizion mesatarja është 32 vjet ndërsa në dy radio stacionet është 38.4 vjet.

RTK-ja, gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe varësisht nga kriteret dhe kushtet e kërkuara në bazë të politikave të RTK-së, ka punësuar dhe vazhdon të punësojë një numër të konsiderueshëm të ish-punëtorëve të ish-Radio Televizionit të Prishtinës. Nisur nga kjo, në vitin 2002, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe i bashkëpunëtorëve në RTK, gjithsej 215 prej tyre kanë qenë ish-punëtorë të Radio Televizionit të Prishtinës, si dhe fëmijë apo bashkëshortë të ish-punëtorëve të RTP-së. Vetëm në Televizionin e Kosovës aktualisht janë të punësuar gjithsej 161 ish-punëtorë të RTP-së, fëmijë apo bashkëshortë të ish-punëtorëve të RTP-së, prej të cilëve 135 me kontrata mbi punësimin dhe 26 me kontrata mbi vepër.

Ndërkaq, në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky janë të punësuar gjithsej 54 ish-punëtorë të RTP-së, me kontratë të rregullt dhe me kontratë mbi vepër.

FINANCAT

Të hyrat e RTK-së në vitin 2002 janë siguruar nga tri burime kryesore: nga pjesa e rezervuar e Buxhetit të Kosovës, nga përkrahja e donatorëve, si dhe nga të hyrat vetanake komerciale (reklamimi gjatë transmetimit, sponsorimet e programeve të caktuara, shërbimet e tjera komerciale). Njëra nga objektivat kryesore të RTK-së gjatë vitit 2002 është përqëndrimi në gjenerimin e të hyrave nga veprimtaria vetanake dhe vendosja e një raporti të balancuar midis burimeve kryesore të financimit.



RTK-ja beson se të hyrat primare, ndonëse jo të vetme, do të duhej të jenë nga parapagimi si një nga mënyrat e zakonshme të financimit të transmetuesit publik.

Grupi i ekspertëve ndërkombëtarë (Task Force Group) në raportin e vet zyrtar thekson se RTK-ja duhet ta aplikojë modelin e financimit të përzier, model ky i domosdoshëm, posaçërisht në vendet e vogla që nuk mund të përkrahin ekonomikisht një nivel të mjaftueshëm të shumës së parapagimit për transmetuesin publik.

Donatorët


RTK-ja është shumë mirënjohëse për përkrahjen e rëndësishme të cilën gjatë vitit ia kanë dhënë Agjencia Evropiane për Rindërtim, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim.

RTK-ja shpreh konsideratë për përkrahjen financiare në mbulimin e zgjedhjeve nga OSBE-ja dhe Press NOW.

Bilanci i gjendjes dhe i suksesit për vitin 2002

Plani i biznesit për vitin 2002 është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së në dhjetor të vitit 2001 dhe u është prezentuar donatorëve.

RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe se mjetet e shpenzuara.



Për herë të parë gjatë vitit 2002, RTK-ja ka bërë korrigjimin e pagave. Janë zbritur pagat e stafit të profilit të përgjithshëm jomedial. Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me rregulloret përkatëse. Departamenti i Financave i RTK-së përpilon raportet financiare mujore dhe tremujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe Bordin e Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politikat e shkruara financiare dhe procedurat strikte të kontrollit të shpenzimeve. RTK-ja ka përcaktuar personat përgjegjës të autorizur për lejimin e shpenzimeve, sipas secilës vijë buxhetore dhe çdo shpenzim mbi 1,500.00 Euro duhet të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, ata me kontrata mbi vepër dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare ashtu sikurse edhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme. Ekziston Rregullorja e shkruar mbi pagesën e mëditjeve për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit, e specifikuar për secilin shtet dhe qytet të botës veçmas.

RTK-ja ka themeluar zyrën e prokurimit me dy punëtorë profesionalë të punësuar pranë kësaj zyre, të cilët, në harmoni me rregulloret në fuqi, i mbikëqyrin dhe zbatojnë në mënyrë strikte procedurat e prokurimit.

Ngritja në vëllim dhe cilësi e programit gjatë vitit 2002 i ka mundësuar RTK-së që, rreth 10% të shpenzimeve për program t'i mbulojë nga sponsorët, jashtë blloqeve standarde të reklamimit. Gjatë vitit 2002 RTK-ja ka aplikuar politikë të ashpër të kursimit dhe ka reduktuar shpenzimet e planifikuara në Planin e Biznesit për 25%, pa i dëmtuar esencialisht planet e saj themelore zhvillimore. Këto kursime janë arritur në saje të menaxhimit të përpikët dhe angazhimit vetëmohues të stafit. Mjetet e kursyera, RTK-ja i ka përdorur për shpenzimet e amortizimit dhe shërbimit satelitor, të cilat kanë qenë të përfshira vetëm me 50% të vlerës reale, në Planin e biznesit për vitin 2002. Përkundër rritjes së vëllimit dhe cilësisë së programit, gjatë vitit 2002,

RTK-ja ka arritur të ketë shpenzime më të ulëta se gjatë vitit 2001, gjë që më së miri flet se RTK-ja vazhdon të ndjekë rrugën e shfrytëzimit maksimal të potencialeve të saj duke arritur kështu efikasitet dhe cilësi më të lartë me shpenzime sa më të ulta.

Me vendimin e Menaxhmentit të RTK-së është shpallur tenderi për përzgjedhjen e kompanisë e cila duhet të bëjë auditimin e afarizmit financiar dhe të përgjithshëm të RTK-së për vitin 2002, sipas standardeve të njohura ndërkombëtare. Raporti komplet i auditimit i është dërguar për informim institucioneve gjegjëse të Kosovës, komunitetit të donatorëve dhe subjekteve të tjera. Në vazhdim do të paraqesim vlerësimin e agjencisë ndërkombëtare për auditim Delloite & Touche për gjendjen e konstatuar në RTK për vitin 2002, si dhe pasqyrat financiare të bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit të RTK-së.

Deloitte & Touche sh.p.k.
Grand Hotel first floor
Prishtina, Kosovo

Tel: +377 44 502871
Fax: +381 38 248139

**Deloitte
& Touche**

Raporti i Auditorit te Pavarur

Ne kemi audituar Bilancin e Gjendjes se Radio Televizionit te Kosoves ("Kompania") deri me 31 Dhjetor 2002 dhe pasqyrat lidhur me veprimtarine, Ndryshimet ne Kapital dhe rrjedhen e Parase per vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2002. Keto Pasqyra Financiare jane pergjegjesi e Menaxhmentit te Kompanise. Pergjegjesia jone eshte qe duke u bazuar ne auditimin tone te shprehim nje mendim mbi keto Pasqyra Financiare.

Ne e kemi kryer Auditimin tone ne perputhshmeri me Standardet Nderkombetare mbi Auditimin. Keto standarde kerkojne qe ne te planifikojme dhe zbatojme auditimin ne menyre qe te perfitojme nje bindje -siguri te arsyshme lidhur me ate nese pasqyrat financiare jane te liruar nga gabimet materiale. Auditimi perfshin kontrollin ne baza te testimi, evidenca qe mbeshtesin shumat dhe shenimet tjera te bashkangjitura ne Pasqyrat Financiare. Auditimi gjithashtu perfshine edhe vleresimin e principeve te kontabilitetit te perdorura dhe disa nga vleresimet me te rendesishme te menaxhmentit si dhe me evaluimin e prezentimit te pergjithshem te Pasqyrave Financiare. Ne besojme se Auditimi jone eshte nje baze reale per mendimin tone.

Mendimi i Auditorit

Sipas mendimit tone,, pasqyrat financiare prezentojne realisht ne cdo aspekt material poziten financiare te Kompanise deri me 31 Dhjetor 2002 dhe rezultatet e veprimtarise, ndryshimet ne kapital dhe rrjedhjen e parase per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor 2002 ne perputhje me Standardet e Raportimit Financiar Nderkombetare.

Pa e kualifikuar mendimin tone, ne terhjekim vemendjen ne shenimin 18 te pasqyres Financiare. Kompania ka realizuar neto te ardhura -Hyra per vitin 2002 ne vlere prej Eur 41,392. Sidoqofte, kjo vlere perfshine te hyrat e pergjithshme nga donatoret ne vlere prej 4,544,455 per periudhen prej 1 Janarit 2002 deri me 31 Dhjetor 2002. Ky fakt ngrit nje dyshim esencial nese Kompania do te jete ne gjendje te vazhdoje te afaroj sipas parimit te vazhdueshmerise pa fonde substanciale te matutjeshme nga donatoret apo burime tjera eksterne. Pasqyrat Financiare nuk perfshijne ndonje korigjim qe mund te jete rezultat i kesaj pasigurie.

Deloitte & Touche


**Deloitte
Touche
Tohmatsu**


RADIO TELEVISIONI I KOSOVES
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2002
 (te gjitha shumat jane ne EURO)

Pasqyra e Gjendjes

	Shenim	31 Dhjetor 2002	1 Janar 2002
PASURITE JO-KORENTE			
Patundshmerite dhe paisjet	3,2, 4	6,656,180	8,010,800
Totali I Pasurise Jo-Korente		6,656,180	8,010,800
Pasuria korente			
Llogarit e arketueshme	5	107,338	84,847
Avanset e Arketueshme	6	48,441	1,259
Mjetet tjera qarkulluese	7	61,578	21,458
Paraja e gatshme dhe ekuvaletet e parave	8	1,703,344	366,489
TOTALI I PASURISE KORENTE		1,920,701	474,053
TOTALI I PASURISE		8,576,881	8,484,853
KAPTALI			
Kapitali	9	8,224,083	8,214,083
Te ardhurat per periudhen		41,392	-
TOTALI I KAPITALIT		8,265,475	8,214,083
Detyrimet Rjedhese			
Llogarit e Pagueshme	10	101,857	128,705
Avanset e Paguara	11	-	91,111
Obligimet e tjera te pagueshme	12	209,549	50,954
TOTALI I DETYRIMEVE		311,406	270,770
TOTALI I DETYRIMEVEVE DHE EKUITETI		8,576,881	8,484,853

I Autorizuar per leshim nga menagjmenti me 27 Qershor 2003:


 Z. Agim Zatriqi
 Drjetor Gjeneral


 Z. Bujar Spahiu
 Drejtör Financiar

Shenimet prej 1 deri ne 15 si pjese integrale e pasqyrave financiare

RADIO TELEVISIONI I KOSOVES
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2002
(te gjitha shumat jane ne EURO)

Pasqyra mbi Afarizmin

	Sheni m	2002
Te hyrat nga afarizmi	13	1,547,250
Shpenzimet nga afarizmi	14	(6,297,962)
(Humbja/Fitimi) Nga Afarizmi		(4,750,712)
Te ardhurat e tjera		
Te ardhurat nga donacionet	15	4,544,455
Rimbursim		199,688
Te ardhurat tjera		83,255
		4,827,398
Shpenzimet tjera		(13,528)
Te ardhura nga aktivitetet tjera		4,813,870
Shpenzimet Financiare		
Shpenzimet Bankare		(21,766)
(Humbje) Nga Aktivitetet Fanciare		(21,766)
Te Ardhurat Para Tatimit ne te Ardhura		41,392
Tatimi ne te ardhura	3.5	-
Neto te Ardhurat		41,392

Shenimet prej 1 deri ne 15 si pjese integrale e pasqyrave financiare

RADIO TELEVISIONI I KOSOVES
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2002
(te gjitha shumat jane ne EURO)

Pasqyra e Ndrimeve ne Ekuitet

	Kapitali	Neto te ardhurat per Periudhen	Total
Bilanci me 1 Janar 2002	8,214,083	-	8,214,083
Donacion (Paisjet)	10,000	-	10,000
Neto te ardhurat per vit	-	41,392	41,392
Bilanci nga 31 Dhjetori 2002	8,224,083	41,392	8,265,475

Shenimet prej 1 deri ne 15 si pjese integrale e pasqyrave financiare